

## Autorizim për Rimbursimin e Ndhmës së Përkohëshme Interim Assistance Reimbursement Authorization

EMRI I KLIENTIT	NUMRI I SIGURIMEVE SHOQËRORE	NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT	NUMRI I TELEFONIT
ADRESA E RRUGËS	QYTETI	SHTETI	KODI POSTAR
ADRESA POSTARE	QYTETI	SHTETI	KODI POSTAR

**Termi Shtet nënkupton Departamentin e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore të Shtetit të Uashingtonit. Termat unë, mua dhe imja nënkuptojnë klientin e përmendur më sipër. Termi SSA nënkupton Administratën e Sigurimeve Shoqërore. Termi SSI nënkupton Të ardhurat e Sigurisë Suplementale të Sigurimeve Shoqërore, që është një program federal i të ardhurave suplementale. Termi Ndhmë e Përkohëshme nënkupton pagesat në të holla të financuara krejtësisht nga fondet e shtetit dhe të dhëna nga Shteti tek ose për llogari të klientit për të përmbushur nevojat bazë të klientit, që më pas publikohen nga një pagesë fillestare ose e rivendosur e SSI-së.**

**C'farë jam duke autorizuar duke nënshkruar këtë formular?**

Nëse kualifikohem për të marrë pagesa të SSI-së, e kuptoj se jam duke autorizuar Komisionerin e SSA-së që t'i japë Shtetit nga pagesat e mia retroaktive të SSI-së një shumë të barabartë me shumën e ndihmës publike të Shtetit që mora.

**A ka Shteti autoritetin për të më kërkuar që të nënshkruaj këtë autorizim?**

Po. Nënshkrimi i autorizimit është një kërkesë për t'u kualifikuar për ndihmë në të holla të financuar nga shteti sipas WAC 388-400-0060 dhe RCW 74.62.030. Nëse refuzoj të nënshkruaj këtë autorizim, nuk mund të marr ndihmë publike të Shtetit.

**Çfarë të bëj nëse SSA më dërgon pagesën e plotë retroaktive?**

E kuptoj se nuk mund të marr ndihmë publike të Shtetit dhe përfitime të SSI-së për të njëjtën periudhë kohore. Kur miratohem për SSI, e kuptoj se ndihma publike e Shtetit bëhet një borxh që i detyrohem dhe duhet t'a ripaguaj. Nëse marr pagesa retroaktive të SSI-së që nuk janë të pakësuara për t'ia ripaguar Shtetit, do t'i telefonoj Zyrës për Rimëkëmbjen Ekonomike në 1-800-562-6114 dhe do të ndjek udhëzimet e tyre sesi të ripaguaj borxhin.

**Për sa kohë është në fuqi ky autorizim?**

Autorizimi duhet të nënshkruhet prej meje dhe një përfaqësues i Shtetit për të qënë i vlefshëm. Është detyrues ndaj Shtetit dhe për mua për një vit kalendarik nga data që Shteti e merr atë dhe pranoj të bëj kërkesë për SSI gjatë asaj kohe.

Kur **është bërë** një kërkesë, ky autorizim **vazhdon të jetë i vlefshëm** deri kur:

- Marr pagesën e parë të SSI-së; ose
- Nuk bëj një kërkesë për rishikim ose apel administrativ dhe koha maksimale e lejuar për të bërë kërkesë ka skaduar; ose
- Shteti dhe unë biem dakord që të përfundojmë autorizimin.

**Ky autorizim nuk është detyrues për mua nëse Shteti nuk njofton SSA-në brenda 30 ditëve nga data që nënshkrova këtë autorizim.**

**A shërben ky autorizim si një kërkesë mbrojtëse për përfitime të SSI-së?**

Po, nëse nuk kam bërë tashme një kërkesë për SSI, SSA duhet të pranojë këtë formular dhe të përdorë datën kur nënshkrova këtë autorizim si data kur bërë kërkesë për SSI nëse bëj kërkesë për SSI brenda 60 ditëve nga data që nënshkrova autorizimin. Nëse nuk bëj një kërkesë për përfitime të SSI-së brenda 60 ditëve, ky autorizim nuk mbron më datën time të bërjes së kërkesës për SSI.

**Kam të drejtën e një Seancë Administrative nëse bie dakord me veprimin e ndërmarrë nga Shteti lidhur me këtë autorizim.**

FIRMA E KLIENTIT	DATA
FIRMA E PËRFAQËSUESIT TË DSHS-SË	DATA E MARË NGA DSHS

